



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 531/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.08.2019 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “*Taulanti*” shpk, në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-21025-05-08-2019, me objekt: “*Shërbim roje civile Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastrë – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj*”, me fond limit 3.379.608 lekë (pa TVSH) zhvilluar më datë 21.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Jugor, Gjirokastrë.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik “A-L Security” shpk, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

“Taulanti” shpk.
Lagjia “18 Shtatori”, Gjirokastrë.

“A-L Security” shpk
Lagjia “18 Shtatori”, Gjirokastrë.

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Rajonit Jugor, Gjirokastrë.
Ish-Zona Industriale, Gjirokastrë.

Subjekte të Interesuara:

“Nazeri 2000” shpk
Adresa: Rruga “Kavajës”, Qendra Condor, kati II, Tiranë.

“Anakonda Security” shpk.
Lagjia “15 Shtatori” banesë një-katëshe nr.32, Tepelenë.

“Anakonda” shpk.
Lagjia “18 Shtatori”, ish shtëpia e ushtarakëve, kati i dytë, Gjirokastër.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë interes për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të bazuar në pikën 1 të nenit 63 të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.4. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.05.2019, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-21025-05-08-2019, me objekt: “*Shërbim roje civile Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastrë – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj*”, me fond limit 3.379.608 lekë (pa TVSH) zhvilluar më datë 21.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Jugor, Gjirokastrë.

II.2. Në datën 21.05.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 04.06.2019 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Anakonda” shpk	3.160.218,16	kualifikuar
2. “Anakonda Security” shpk	3.160.218,16	kualifikuar
3. “Nazeri 2000” shpk	3.160.218,16	kualifikuar
4. “A-L Security” shpk	3.160.218,16	skualifikuar
5. “Bizhga-1” shpk	3.160.218,16	skualifikuar
6. “Taulanti” shpk	3.160.218,16	skualifikuar

II.4. Në datën 04.06.2019, operatori ekonomik “*Taulanti*” shpk është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e procedurës së prokurimit, si dhe skualifikimin e tij në procedurën e mësipërme të prokurimit me pretendimin si më poshtë:

“Operatori Ekonomik “Taulanti” nuk plotëson kriteret e kualifikimit si më poshtë:

1. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Operatori Ekonomik “A-L Sesurity” dhe Operatori Ekonomik “Taulanti” kanë paraqitur vërtetime nga OSHEE Gjirokastrë përkatësisht me nr. 676 prot dhe nr. 677 prot, datë 14.05.2019 për të njëjtën Kontratë dhe me të njëjtin Kod, megjithëse këta Operatorë Ekonomike kanë Qendra Kontrolli të ndryshme sipas vërtetimeve të lëshuara nga DPV Gjirokastrë. Bazuar në nenin 65 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, të dy Operatorët Ekonomikë skualifikohen nga procedura.

2. Nuk plotëson kriterin e Qendrës së Kontrollit, pasi sipas Udhëzimit nr. 130, datë 05.03.2018 të Ministrisë të Punëve të Brendshme, kreu 7, pika D/5 ku në aktin e miratimit të Qendrës së Kontrollit bashkëlidhet lista dokumentacionit dhe pajisjeve.”.

II.5. Operatori ekonomik “Taulanti” shpk, në datën 10.06.2019 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit, sipas pretendimeve si më poshtë vijon:

Në datën 10.05.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozime” me Nr. REF-21278-05-09-2019, me objekt, “Shërbim me roje civile për Drejtorinë e Rajonit Jugor Gjirokastrë - Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj”, me fond limit 3.379.608 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 21.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastrë.

Në datën 04.06.2019, Komisioni Vlerësimit të Ofertave ka bërë vlerësimin e procedurës së prokurimit, në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

1. “Anakonda” Sh.p.k	3,160,218.16	lekë	kualifikuar
2. “Anakonda Security” Sh.p.k	3,160,218.16	lekë	kualifikuar
3. “Nazeri - 2000” Sh.p.k	3,160,218.16	lekë	kualifikuar
4. “A L Security” Sh.p.k	3,160,218.16	lekë	skualifikuar
5. “Bizhga-1” Sh.p.k	3,160,218.16	lekë	skualifikuar
6. “Taulanti” Sh.p.k	3,160,218.16	lekë	skualifikuar

Në datën 04.06.2019, Sh.p.s.f “Taulanti” Sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentat si më poshtë:

Operatori ekonomik “Taulanti” nuk plotëson kriteret e kualifikimit si më poshtë;

1. Vërtetimi që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike që ka operatori ekonomik që është rregjistruar në Shqipëri. Operatori ekonomik “A - L Security” dhe operatori ekonomik “Taulanti” kanë paraqitur vërtetime nga OSHEE Gjirokastrë me nr.676 prot dhe nr. 677 prot datë 14.05.2019 për të njëjtën kontratë me të njëjtin kod, megjithëse këta operatorë ekonomik kanë Qendra Kontrolli të ndryshme sipas vërtetimeve lëshuar nga DVP Gjirokastrë. Bazuar në neni 65 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar të dy operatorët ekonomik skualifikohen nga procedura.

2. Nuk plotëson kriterin e Qendrës të Kontrollit pasi sipas Udhëzimit nr.130, datë 05.03.2018 të Ministrisë të Punëve të Brendshme, kreu 7, pika D/5 ku në Aktin e miratimit të Qendrës të Kontrollit bashkalidhet lista e dokumentacionit dhe paisjeve. Në zbatim të nenit 63, pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me ndyshimet, paraqesim ankesë prane Komisionit Vlerësimit të Ofertave duke kërkuar kualifikimin e ofertës tonë, duke argumentuar më poshtë:

Përsa i përket pikës 1 të skualifikimit, në dokumentet e procedurës së prokurimit është kërkuar në pikën

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, pika dh: “Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.”.

Për plotësimin e kriterit, në dosjen e tenderit kemi dorëzuar vërtetim lëshuar nga OSHEE Gjirokastrë me nr. 677 prot, datë 14.05.2019, ku rezulton se shoqëria “Taulanti” të ketë 0 detyrime për faturat e

energjisë elektrike vlerë e llogaritur deri në datë 14.05.2019 duke përfshirë faturen koherente të muajit Prill 2019. Vërtetimi më sipër e përmbush plotësisht kërkesën tuaj.

Kontratën e qirasë nr. 148 Rep, nr. 72 Kol, datë 25.01.2019, ku vërtetohet se Sh.p.s.f “Taulanti” Sh.p.k dhe shoqërisë “XXXXXX” Sh.p.k kanë marrë me qera objekin.

Sh.p.s.f “Taulanti” Sh.p.k ka selinë qendrore, si dhe Qendrën e Kontrollit, çka e vërteton Ekstrakti Historik i shoqërisë.

Akt marrveshjen midis shoqërisë “Taulanti” Sh.p.k dhe shoqërisë “XXXXXX” Sh.p.k, ku palët qiramarëse kanë rënë dakort që detyrimet për likuidimin e detyrimeve për energjinë elektrike në OSHEE Gjirokastrë për kontratën me Kod 36651 ti paguajë shoqëria “XXXXXX” Sh.p.k sipas kontratës të qirasë nr. 148 Rep, nr. 72 Kol, datë 25.01.2019.

Neni 65, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku thuhet: “Ndërhyrja në ofertë” Asnjë ofertues nuk mund të marrë pjesë në ofertën e dikujt tjetër për të njëjtën kontratë, në çfarëdolloj Kapaciteti. Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.”.

Për më tepër në dokumentet standarte të tenderit në faqen ëëë. app gov. al, si dhe në dokumentet e procedurës së prokurimit me Nr. REF-21278-05-09-2019, me objekt, “Shërbim me roje civile për Drejtorinë e Rajonit Jugor Gjirokastrë”, pika dh. “Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri është përfshirë në KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, dhe jo në KAPACITET TEKNIKE apo FINANCIARE.

Theksojmë se nuk është e kundraligjshme dhe nuk ndalohet që dy shoqëri të kenë seli në të njëjtin objekt, ku secila ka ambientin e saj, paguan detyrimet sipas përcaktimeve ligjore.

Sa më sipër Sh.p.s.f “Taulanti” Sh.p.k, ka plotësuar kërkesën në përputhje me dokumentat e tenderit, si dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, dhe Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me ndyshimet përkatëse.

Përsa i përket pikës 2 të skualifikimit, në dokumentet e procedurës së prokurimit është kërkuar në pikën 2.3 “Kapaciteti teknik” pika 2: “Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Policia e Shtetit në Qarkun ku ushtron aktivitetin SHPSF, si dhe Dokumenti i Performancës mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik.

Për këtë duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Gjirokastrë ku jepet informacioni i mësipërm i kërkuar.”.

Për plotësimin e kriterit në dosjen e tenderit kemi dorëzuar Akt Miratimin e Qendrës të kontrollit nr.1354/b prot, datë 12.07.2018.

Vërtetimin nr.1493 prot, datë 06.05.2019 lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë, i cili përmban të dhëna të plota në lidhje me kapacitetet e Sh.p.s.f “Taulanti” Sh.p.k, si dhe lista e dokumentacionit dhe paisjeve.

Në përfundim, kemi plotësuar të gjitha kërkesat tuaja për aq sa ju keni kërkuar në dokumentet e procedurës të prokurimit, në përputhje me Ligjin nr.75/2014, datë 10.07.2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, si dhe Udhëzimit nr.130, datë 05.03.2018 të “Ministrit të Punëve të Brendshme”, si dhe VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar dhe Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me ndyshimet përkatëse.

Autoriteti kontraktor në vlerësimin e ofertave nuk mund të përdorë asnjë kriter i cili nuk është i përfshirë në dokumentat e tenderit. Autoriteti kontraktor vlerëson ofertat, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.

Kërkojmë kualifikimin e ofertës të Sh.p.s.f “Taulanti” Sh.p.k, e cila është në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, si dhe me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me ndryshimet përkatëse, Ligjin nr.75/2014 datë 10.07.2014 “Për sheerbimin privat të sigurisë fizike” dhe Udhëzimit nr.130, datë 05.03.2018 të Ministrit të Punëve të Brendshme.

Sa më sipër, kërkojmë:

1. Pezullimin të procedurës së prokurimit.
2. Pranimin e ankesës së operatorit ekonomik “Taulanti” Sh.p.k.
3. Shfuqizim i vendimit datë 04.06.2019 të KVO-së përsa i përket statusit “refuzuar/skualifikuar”, ofertës së Sh.p.s.f “Taulanti” Sh.p.k duke e “pranuar/kualifikuar” atë.

II.6. Me anë të shkresës nr. 337/1 prot., datë 12.06.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke mos e pranuar atë.

II.7. Në datën 21.06.2019 operatori ekonomik “Taulanti” shpk ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e ngritur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Në datën 04.06.2019, operatori ekonomik “A-L Security” shpk është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e procedurës së prokurimit, si dhe skualifikimin e tij në procedurën e mësipërme të prokurimit me pretendimin si më poshtë:

“Operatori Ekonomik “A-L Security” nuk plotëson kriteret e kualifikimit si më poshtë:

1. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Operatori Ekonomik “A-L Security” dhe Operatori Ekonomik “Taulanti” kanë paraqitur vërtetime nga OSHEE Gjirokastër përkatësisht me nr. 676 prot dhe nr. 677 prot, datë 14.05.2019 për të njëjtën Kontratë dhe me të njëjtin Kod, megjithëse këta Operatorë Ekonomikë kanë Qendra Kontrolli të ndryshme sipas vërtetimeve të lëshuara nga DPV Gjirokastër. Bazuar në nenin 65 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, të dy Operatorët Ekonomikë skualifikohen nga procedura.

2. Nuk plotëson kriterin e Qendrës së Kontrollit, pasi sipas Udhëzimit nr. 130, datë 05.03.2018 të Ministrit të Punëve të Brendshme, kreu 7, pika D/5 ku në aktin e miratimit të Qendrës së Kontrollit bashkëlidhet lista dokumentacionit dhe pajisjeve.”.

II.9. Operatori ekonomik “A-L Security” shpk, në datën 10.06.2019 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit, sipas pretendimeve si më poshtë vijon:

Në datën 10.05.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozime” me Nr. REF-21278-05-09-2019, me objekt, “Shërbim me roje civile për Drejtorinë e Rajonit Jugor Gjirokastrë - Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj”, me fond limit 3.379.608 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 21.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastrë.

Në datën 04.06.2019, Komisioni Vlerësimit të Ofertave ka bërë vlerësimin e procedurës së prokurimit, në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

1. “Anakonda” Sh.p.k	3,160,218.16	lekë	kualifikuar
2. “Anakonda Security” Sh.p.k	3,160,218.16	lekë	kualifikuar
3. “Nazeri - 2000” Sh.p.k	3,160,218.16	lekë	kualifikuar
4. “A L Security” Sh.p.k	3,160,218.16	lekë	skualifikuar
5. “Bizhga-1 “ Sh.p.k	3,160,218.16	lekë	skualifikuar
6. “Taulanti” Sh.p.k	3,160,218.16	lekë	skualifikuar

Në datën 04.06.2019, Sh.p.s.f “A-L Security” Sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentat si më poshtë:

Operatori ekonomik “A-L Security” nuk plotëson kriteret e kualifikimit si më poshtë:

1. Vërtetimi që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike që ka operatori ekonomik që është rregjistruar në Shqipëri. Operatori ekonomik “A - L Security” dhe operatori ekonomik “Taulanti” kanë paraqitur vërtetime nga OSHEE Gjirokastrë me nr.676 prot dhe nr. 677 prot datë 14.05.2019 për të njëjtën kontratë me të njëjtin kod, megjithëse këta operatorë ekonomik kanë Qendra Kontrolli të ndryshme sipas vërtetimeve lëshuar nga DVP Gjirokastrë. Bazuar në neni 65 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar të dy operatorët ekonomik skualifikohen nga procedura.

2. Nuk plotëson kriterin e Qendrës të Kontrollit pasi sipas Udhëzimit nr.130, datë 05.03.2018 të Ministrisë të Punëve të Brendshme, kreu 7, pika D/5 ku në Aktin e miratimit të Qendrës të Kontrollit bashkalidhet lista e dokumentacionit dhe paisjeve. Në zbatim të nenit 63, pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me ndyshimet, paraqesim ankesë prane Komisionit Vlerësimit të Ofertave duke kërkuar kualifikimin e ofertës tonë, duke argumentuar më poshtë:

Përsa i përket pikës 1 të skualifikimit, në dokumentet e procedurës së prokurimit është kërkuar në pikën

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, pika dh: “Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.”.

Për plotësimin e kriterit, në dosjen e tenderit kemi dorëzuar vërtetim lëshuar nga OSHEE Gjirokastrë me nr. 676 prot, datë 14.05.2019, ku rezulton se shoqëria “A-L Security” të ketë 0 detyrime për faturat

e energjisë elektrike vlerë e llogaritur deri në datë 14.05.2019 duke përfshirë faturen koherente të muajit Prill 2019. Vërtetimi më sipër e përmbush plotësisht kërkesën tuaj.

Kontratën e qirasë nr. 148 Rep, nr. 72 Kol, datë 25.01.2019, ku vërtetohet se Sh.p.s.f “A-L Security” Sh.p.k ka marrë me qera objektin ku kemi selinë qendrore çka e vërteton Ekstrakti Historik i shoqërisë. Sh.p.s.f “A-L Security” Sh.p.k ka selinë qendrore, si dhe Qendrën e Kontrollit, çka e vërteton Ekstrakti Historik i shoqërisë.

Akt marrvëshjen midis shoqërisë “A-L Security” Sh.p.k dhe shoqërisë “XXXXXX” Sh.p.k, ku palët qiramarëse kanë rënë dakort që detyrimet për likuidimin e detyrimeve për energjinë elektrike në OSHEE Gjirokastrë për kontratën me Kod 36651 ti paguajë shoqëria “A-L Security” Sh.p.k sipas kontratës të qirasë nr. 148 Rep, nr. 72 Kol, datë 25.01.2019.

Neni 65, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku thuhet: “Ndërhyrja në ofertë” Asnjë ofertues nuk mund të marrë pjesë në ofertën e dikujt tjetër për të njëjtën kontratë, në çfarëdolloj Kapaciteti. Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.”.

Për më tepër në dokumentet standarte të tenderit në faqen www.app.gov.al, si dhe në dokumentet e procedurës së prokurimit me Nr. REF-21278-05-09-2019, me objekt, “Shërbim me roje civile për Drejtorinë e Rajonit Jugor Gjirokastrë”, pika dh. “Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri është përfshirë në KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, dhe jo në KAPACITET TEKNIKE apo FINANCIARE.

Theksojmë se nuk është e kundraligjshme dhe nuk ndalohej që dy shoqëri të kenë seli në të njëjtin objekt, ku secila ka ambientin e saj, paguan detyrimet sipas përcaktimeve ligjore.

Sa më sipër Sh.p.s.f “A-L Security” Sh.p.k, ka plotësuar kërkesën në përputhje me dokumentat e tenderit, si dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, dhe Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me ndryshimet përkatëse.

Përsa i përket pikës 2 të skualifikimit, në dokumentet e procedurës së prokurimit është kërkuar në pikën 2.3 “Kapaciteti teknik” pika 2: “Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Policia e Shtetit në Qarkun ku ushtron aktivitetin SHPSF, si dhe Dokumenti i Performancës mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik.

Për këtë duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Gjirokastrë ku jepet informacioni i mësipërm i kërkuar.”.

Për plotësimin e kriterit në dosjen e tenderit kemi dorëzuar Akt Miratimin e Qendrës të kontrollit nr.701/b prot, datë 19.03.2018.

Vërtetimin nr.1492 prot, datë 06.05.2019 lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë, i cili përmban të dhëna të plota në lidhje me kapacitetet e Sh.p.s.f “A-L Security” Sh.p.k, i cili përmban të dhëna të plota në lidhje me kapacitetet e Sh.p.s.f “A-L Security” Sh.p.k.

Përsa i përket citimit tuaj, megjithëse këta operatorë ekonomik kanë Qendra Kontrolli të ndryshme sipas vërtetimeve lëshuar nga DVP Gjirokastrë, sqarojmë se Sh.p.s.f “A-L Security” Sh.p.k disponon Qendër Kontrolli në adresën si dhe citon vërtetimin nr.1492 prot, datë 06.05.2019 lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë.

Sa më sipër, kemi plotësuar të gjitha kërkesat tuaja për aq sa ju keni kërkuar në dokumentet e procedurës të prokurimit, në përputhje me Ligjin nr.75/2014, datë 10.07.2014 “Për sheerbimin privat të sigurisë fizike”, si dhe Udhëzimit nr.130, datë 05.03.2018 të “Ministrit të Punëve të Brendshme”, si dhe VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar dhe Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me ndyshimet përkatëse.

Autoriteti kontraktor në vlerësimin e ofertave nuk mund të përdorë asnjë kriter i cili nuk është i përfshirë në dokumentat e tenderit. Autoriteti kontraktor vlerëson ofertat, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër, kërkojmë:

- 1. Pezullimin të procedurës së prokurimit.*
- 2. Pranimin e ankesës së operatorit ekonomik Sh.p.s.f “A-L Security” Sh.p.k*
- 3. Shfuqizim i vendimit datë 04.06.2019 të KVO-së përsa i përket statusit “refuzuar/skualifikuar”, ofertës së Sh.p.s.f “A-L Security” Sh.p.k duke e “pranuar/kualifikuar” atë.*

II.10. Me anë të shkresës nr. 336/1 prot., datë 12.06.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke mos e pranuar atë.

II.11. Në datën 21.06.2019 operatori ekonomik “A-L Security” shpk ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime, si në ankesën e ngritur pranë autoritetit kontraktor.

II.12. Nëpërmjet shkresës nr. 337/5 prot., datë 03.07.2019, protokolluar me tonën në datën 05.07.2019, me objekt “Dërgim Informacioni” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorëve ekonomikë ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Taulanti” shpk, për kundërshtimin e skualifikimit të paraqitur prej tij, me pretendimin se: “Përsa i përket pikës 1 të skualifikimit, në dokumentet e procedurës së prokurimit është kërkuar në pikën 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, pika dh: “Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.”.

Për plotësimin e kriterit, në dosjen e tenderit kemi dorëzuar vërtetim lëshuar nga OSHEE Gjirokastrë me nr. 677 prot, datë 14.05.2019, ku rezulton se shoqëria "Taulanti" të ketë 0 detyrime për faturat e energjisë elektrike vlerë e llogaritur deri në datë 14.05.2019 duke përfshirë faturen koherente të muajit Prill 2019. Vërtetimi më sipër e përmbush plotësisht kërkesën tuaj.

Kontratën e qirasë nr. 148 Rep, nr. 72 Kol, datë 25.01.2019, ku vërtetohet se Sh.p.s.f "Taulanti" Sh.p.k dhe shoqërisë "XXXXXX" Sh.p.k kanë marrë me qera objektin. Sh.p.s.f "Taulanti" Sh.p.k ka selinë qendrore, si dhe Qendrën e Kontrollit, çka e vërteton Ekstrakti Historik i shoqërisë. Akt marrvëshjen midis shoqërisë "Taulanti" Sh.p.k dhe shoqërisë "XXXXXX" Sh.p.k, ku palët qiramarëse kanë rënë dakort që detyrimet për likuidimin e detyrimeve për energjinë elektrike në OSHEE Gjirokastrë për kontratën me Kod 36651 ti paguajë shoqëria "XXXXXX" Sh.p.k sipas kontratës të qirasë nr. 148 Rep, nr. 72 Kol, datë 25.01.2019. Neni 65, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, ku thuhet: "Ndërhyrja në ofertë" Asnjë ofertues nuk mund të marrë pjesë në ofertën e dikujt tjetër për të njëjtën kontratë, në çfarëdolloj Kapaciteti. Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.". Për më tepër në dokumentet standarte të tenderit në faqen ëëë. app gov. al, si dhe në dokumentet e procedurës së prokurimit me Nr. REF-21278-05-09-2019, me objekt, "Shërbim me roje civile për Drejtorinë e Rajonit Jugor Gjirokastrë", pika dh. "Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri është përfshirë në KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, dhe jo në KAPACITET TEKNIKE apo FINANCIARE. Theksojmë se nuk është e kundraligjshme dhe nuk ndalohet që dy shoqëri të kenë seli në të njëjtin objekt, ku secila ka ambientin e saj, paguan detyrimet sipas përcaktimeve ligjore. Sa më sipër Sh.p.s.f "Taulanti" Sh.p.k, ka plotësuar kërkesën në përputhje me dokumentat e tenderit, si dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, dhe Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", me ndryshimet përkatëse. " dhe pretendimin e operatorit ekonomik "A-L Security" shpk për kundërshtimin e skualifikimit të paraqitur prej tij, me pretendimin se: "Për plotësimin e kriterit, në dosjen e tenderit kemi dorëzuar vërtetim lëshuar nga OSHEE Gjirokastrë me nr. 676 prot, datë 14.05.2019, ku rezulton se shoqëria "A-L Security" të ketë 0 detyrime për faturat e energjisë elektrike vlerë e llogaritur deri në datë 14.05.2019 duke përfshirë faturen koherente të muajit Prill 2019. Vërtetimi më sipër e përmbush plotësisht kërkesën tuaj. Kontratën e qirasë nr. 148 Rep, nr. 72 Kol, datë 25.01.2019, ku vërtetohet se Sh.p.s.f "A-L Security" Sh.p.k ka marrë me qera objektin ku kemi selinë qendrore çka e vërteton Ekstrakti Historik i shoqërisë. Sh.p.s.f "A-L Security" Sh.p.k ka selinë qendrore, si dhe Qendrën e Kontrollit, çka e vërteton Ekstrakti Historik i shoqërisë. Akt marrvëshjen midis shoqërisë "A-L Security" Sh.p.k dhe shoqërisë "XXXXXX" Sh.p.k, ku palët qiramarëse kanë rënë dakort që detyrimet për likuidimin e detyrimeve për energjinë elektrike në OSHEE Gjirokastrë për kontratën me Kod 36651 ti paguajë shoqëria "A-L Security" Sh.p.k sipas kontratës të qirasë nr. 148 Rep, nr. 72 Kol, datë 25.01.2019. Neni 65, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, ku thuhet: "Ndërhyrja në ofertë" Asnjë ofertues nuk mund të marrë pjesë në ofertën e dikujt tjetër për të njëjtën kontratë, në çfarëdolloj Kapaciteti. Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.". Për më tepër në dokumentet standarte të

tenderit në faqen www.app.gov.al, si dhe në dokumentet e procedurës së prokurimit me Nr. REF-21278-05-09-2019, me objekt, “Shërbim me roje civile për Drejtorinë e Rajonit Jugor Gjirokastrë”, pika dh. “Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri është përfshirë në KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, dhe jo në KAPACITET TEKNIKE apo FINANCIARE. Theksojmë se nuk është e kundraligjshme dhe nuk ndalohej që dy shoqëri të kenë seli në të njëjtin objekt, ku secila ka ambientin e saj, paguan detyrimet sipas përcaktimeve ligjore. Sa më sipër Sh.p.s.f “A-L Security” Sh.p.k, ka plotësuar kërkesën në përputhje me dokumentat e tenderit, si dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndyshuar, dhe Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me ndyshimet përkatëse.”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7, “Kriteret e veçanta për kualifikim” Pika 2.1.dh të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se: “Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.”.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatorët ekonomikë “Taulanti” sh.p.k dhe “A-L Security” shpk, në përmbushje të kriterit sa më sipër kanë dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim Debie nr. 677 prot., datë 14.09.2019, ku citohet: [...] Bazuar në deklaratimet e deklaruesit... vërtetojmë se kërkuuesi Taulanti shpk nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën /kontratën me kod XXXXXXXXXX titullar dhe përdorues i së cilës/cilave është A-L Security shpk, rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 14.05.2019, duke përfshirë faturën koherente të muajit Prill 2019.

- Vërtetim Debie nr. 676 prot., datë 14.09.2019, ku citohet: [...] Bazuar në deklaratimet e deklaruesit... vërtetojmë se kërkuuesi A-L Security shpk nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën /kontratën me kod XXXXXXXXXX titullar dhe përdorues i së cilës/cilave është A-L Security shpk, rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 14.05.2019, duke përfshirë faturën koherente të muajit Prill 2019.

- Kontrate qeraje Nr.148 rep, date 25.01.2019, midis qeradhënësit z.T.Ç dhe dy qeramarrësve dhe përkatësisht shoqëria “A-L Security” shpk dhe shoqëria “Taulanti” shpk, me objekt: “Dhënie me qera e një objekti, pasuri me nr.24/76-G6”.

- Aktmarrvëshje e lidhur midis shoqërisë “Taulanti” shpk dhe shoqërisë “A-L Security” shpk, ku përcaktohet se; “Refruar kontratës së qerasë nr.148 rep, datë 25.01.2019, nenit 6 “Të drejtat dhe detyrimet e palëve” ku ndër të tjera thuhet se: “Qeramarrësit marrin përsipër të paguajnë detyrimet për energjinë elektrike sipas kontratës nr.K36351, ujë dhe telefon”, pra palët e mësipërme bien dakort që këto detyrime do ti paguajë shërbimi privat i sigurisë fizike “A-L Security” shpk.”.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.1.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 5, gërma “c”, përcaktohet se: “Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: “c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.”.

III.1.5 Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.”.

III.1.6. Referuar korrespondencës që Komisioni i Prokurimit Publik ka pasur me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, është vënë në dijeni nga kjo e fundit, se pasi bëhen verifikimet përkatëse lëshohet “Vërtetim Debit” sipas formatit standard për të gjitha subjektet aplikuese. “[.../ Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike lëshon vërtetimet e debisë, bazuar në deklaratimet vullnetare të subjekteve kërkues të kontratave të energjisë elektrike. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike evidenton saktësinë e dokumentacionit të paraqitur si më poshtë: 1. Tërësinë e kontratave të deklaruara nga subjekti (në rast se mund të ketë kontrata të tjera të padeklaruara). 2. Kontratat e furnizimit për objektet e tyre, duhet të jenë të tarifuara si private. 3. Kontratat e furnizimit duhet të jenë në emër të subjektit, përveç rasteve kur ato janë ambiente të marra me qira. Në rast se subjekti ka paraqitur kontrata familiare, Operatori i kërkon këtij të fundit ndryshimin e tarifimit dhe pagesën me faturën e ardhshme të diferencës së cmimit bazuar në legjislacionin në fuqi dhe kontratën e furnizimit me energji elektrike. Të gjithë operatorët që kërkojnë të pajisen me Vërtetimin e Debitit duhet të aplikojnë pranë Qendrave të KNK në të gjithë Shqipërinë dhe lëshimi do të jetë i mundur jo më vonë se pesë ditë pas kërkesës nga subjekti. Mosplotësimi i kriterëve të mësipërme do të rezultojë me moslëshimin e Vërtetimit të Debitit nga Drejtoria Qendrore ose Drejtoritë Rajonale. Modeli zyrtar i lëshimit të Vërtetimit të Debitit në të gjitha rastet e statusit të Operatorëve përmbledh informacionin

përkatës për rastet kur: 1. Konsumatori nuk rezulton debitor në Sistemin e Faturimit. 2. Konsumatori rezulton debitor. 3. Konsumatori rezulton debitor por ka lidhur një aktmarrëveshje për shlyerjen e detyrimeve me këste. 4. konsumatori rezulton debitor por është në proces ankimi dhe ankesa është në trajtim nga strukturat e OSHEE-së. 5. Konsumatori rezulton debitor por vlera është e ankimuar në gjykatë.[...]”.

III.1.7. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se përmes dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike operatorët ekonomikë “Taulanti” sh.p.k dhe “A-L Security” sh.p.k vërtetojnë se kanë marrë me qera pasurinë me numër nr.24/76-G6 në qytetin e Gjirokastrës, të cilën e ndajnë midis tyre dhe për këtë ambient kanë paraqitur vërtetimet e OSHEE-së ku përcaktohet se kanë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, pra kontrata energjisë së këtij numri pasurie nuk ka detyrime të paslyera të energjisë elektrike. Referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit përkatësisht 21.05.2019 dhe Nenit 9, paragrafi 1 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, operatori ekonomik operatorët ekonomikë “Taulanti” sh.p.k dhe “A-L Security” sh.p.k kanë përmbushur detyrimet ligjore për shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike. KPP gjykon se institucioni i OSHEE-së menaxhon sistemin e të dhënave për pagimin e energjisë elektrike për të gjithë subjektet përdoruese të energjisë elektrike për të gjithë kontratat e lidhura midis OSHEE-së dhe subjekteve përdoruese të energjisë elektrike.

Sa më sipër pretendimi i ankimesve qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Taulanti” shpk, për kundërshtimin e skualifikimit të paraqitur prej tij, me pretendimin se: “Përsa i përket pikës 2 të skualifikimit, në dokumentet e procedurës së prokurimit është kërkuar në pikën 2.3 “Kapaciteti teknik” pika 2: “Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Policia e Shtetit në Qarkun ku ushtron aktivitetin SHPSF, si dhe Dokumenti i Performancës mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik.

Për këtë duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Gjirokastrë ku jepet informacioni i mësipërm i kërkuar.”. Për plotësimin e kriterit në dosjen e tenderit kemi dorëzuar Akt Miratimin e Qendrës të kontrollit nr.1354/b prot, date 12.07.2018. Vërtetimin nr.1493 prot, datë 06.05.2019 lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë, i cili përmban të dhëna të plota në lidhje me kapacitetet e Sh.p.s.f “Taulanti” Sh.p.k, si dhe lista e dokumentacionit dhe paisjeve. Në përfundim, kemi plotësuar të gjitha kërkesat tuaja për aq sa ju keni kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, në përputhje me Ligjin nr.75/2014, datë 10.07.2014 “Për sheerbimin privat të sigurisë fizike”, si dhe Udhëzimit nr.130, datë 05.03.2018 të “Ministrit të Punëve të Brendshme”, si dhe VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar dhe Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me ndyshimet përkatëse. Autoriteti kontraktor në vlerësimin e ofertave nuk mund të përdorë asnjë kriter i cili nuk është i përfshirë në dokumentat e tenderit. Autoriteti kontraktor vlerëson ofertat, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.” dhe pretendimin e operatorit ekonomik

“A-L Security” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të paraqitur prej tij, me pretendimin se: “Përsa i përket pikës 2 të skualifikimit, në dokumentet e procedurës së prokurimit është kërkuar në pikën 2.3 “Kapaciteti teknik” pika 2: “Akti i Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Policia e Shtetit në Qarkun ku ushtron aktivitetin SHPSF, si dhe Dokumenti i Performancës mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik.

Për këtë duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Gjirokastrë ku jepet informacioni i mësipërm i kërkuar.”. Për plotësimin e kriterit në dosjen e tenderit kemi dorëzuar Akt Miratimin e Qendrës të kontrollit nr.701/b prot, date 19.03.2018. Vërtetimin nr.1492 prot, datë 06.05.2019 lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë, i cili përmban të dhëna të plota në lidhje me kapacitetet e Sh.p.s.f “A-L Security” Sh.p.k, i cili përmban të dhëna të plota në lidhje me kapacitetet e Sh.p.s.f “A-L Security” Sh.p.k. Përsa i përket citimit tuaj, megjithëse këta operatorë ekonomik kanë Qendra Kontrolli të ndryshme sipas vërtetimeve lëshuar nga DVP Gjirokastrë, sqarojmë se Sh.p.s.f “A-L Security” Sh.p.k disponon Qendër Kontrolli në adresën si dhe citon vërtetimin nr.1492 prot, datë 06.05.2019 lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë.”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1. Nga shqyrtimi i Shtojcës.7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi konstatohet se nuk parashikohet që operatorët ekonomik ofertues duhet që të paraqesin sëbashku me Aktin e Miratimit të Qendrës së Kontrollit dhe lista e dokumentacionit dhe paisjeve.

III.2.2. Në nenin 46, pika 1, gërma “c”, të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur;”.

III.2.3. Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.2.4. Në nenin 28 pika 5 gërma “ç” “Kontratat e Shërbimeve” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.

III.2.5. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta, duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik thekson pozitën e tij të veçantë si një organ *quazi gjyqësor* dhe si i tillë në vendimarrjen e tij bazohet në fakt, prova dhe ligj. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kritereve të tjera të kualifikimit të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm që është në kundërshtim me nenin 55 pika 2 e LPP-së, i cili parashikon se “*Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*”, por cënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 2 i *lex specialis*, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve. Në rastin konkret, KPP konstaton se referuar kritereve të veçanta të kualifikimit autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar në asnjë rast që ofertuesit të paraqesin sëbashku me Aktin e Miratimit të Qendrës së Kontrollit dhe listën e dokumentacionit dhe paisjeve. KPP gjykon se në cilësinë e një organi *quazi gjyqësor*, në vendimarrjen e tij, ky fundit i referohet parimeve të së drejtës *Judicis est judicare secundum allegata et probate* (organi vendos në bazë të fakteve dhe provave të administruara në proces). KPP nuk mund të gjykojë për plotësimin e kritereve të veçanta të kualifikimit mbi kritere të cilat nuk janë parashikuar shprehimisht në dokumentet e tenderit.

Rrjedhimisht, pretendimi i ankimuesve qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “*Taulanti*” shpk, për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-21025-05-08-2019, me objekt: “*Shërbim roje civile Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastrë – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj*”, me fond limit 3.379.608 lekë (pa TVSH) zhvilluar më datë 21.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Jugor, Gjirokastrë.

2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “A-L Security” shpk për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorëve ekonomikë “Taulanti” shpk dhe “A-L Security” shpk, duke i kualifikuar këta operatorë ekonomikë.
4. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
6. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “Taulanti” shpk dhe “A-L Security” shpk.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 1122 Protokolli Nr. 1123 Protokolli

Datë 21.06.2019 Datë 21.06.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha